



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Ministartstvo za Finansija, Rada i Transfera

Ministry of Finance, Labor and Transfers

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit TM3 2021



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin me të dhëna për Transportin Rrugor, Hekurudhor, Ajror dhe Telekomunikimin. Ky publikim statistikor paraqet të dhëna statistikore me bazë vjetore nga viti 2011 deri në vitin 2020 për mjetet motorike dhe jo motorike, si dhe për rrugët e Kosovës, kurse të dhënat statistikore me bazë tremujore janë nga viti 2011 deri në tremujorin dytë të vitit 2021 për transportin ajror, hekurudhor dhe telekomunikimin.

Qëllimi i publikimit është të paraqesë tendencën e zhvillimit të këtij sektori për ekonominë e vendit. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së, dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën. Bazuar në kërkesën e Eurostat-it duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2018 (TM 2 2018), publikimi ka pësuar disa ndryshime në pjesën e telekomunikimit, duke përfshirë të dhëna edhe nga operatore të tjerë, në mënyrë që të mbulohen të gjitha shërbimet e telekomunikimit të ofruara në vendin tonë.

Ky publikim është përgatitur nga :

Ismail Sahiti	- Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit
Hysni Elshani	- Zëvendësues i Udhëheqësit të divizionit të Statistikave Ekonomike
Dafina Kumonva	- Zyrtare e Statistikave Ekonomike
Qendresa Shala Sopaj	- Zyrtare e Statistikave Ekonomike
Bekim Bojku	- Zyrtar i Statistikave Ekonomike
Ahmet Cakolli	- Zyrtar për dizajn

Tetor, 2021

Zëvendësues i Kryeshefit Ekzekutiv i ASK-së,
z. Ilir T. Berisha

Përmbajtja

Faqe

1. Metodologjia dhe përkufizimet.....	3
1.1 Metodologji	3
1.2 Mbulimi	3
1.3 Përkufizime	3
2. Transporti Hekurudhor.....	5
3. Transporti Ajror.....	7
4. Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara	10
5. Rrugët e Kosovës	11
6. Telekomunikimi.....	14
6.1. Përdoruesit dhe Impulset e telefonisë fikse.....	14
6.2. Përdoruesit dhe Impulset e telefonisë mobile.....	15
6.3. Kapaciteti i zyrave Postare.....	17

1. Metodologjia dhe përkufizimet

1.1 Metodologji

Burimet e të dhënave janë administrative ku dhënësit e informatave (të dhënave) janë Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti për Regjistrimin e Automjeteve të Kosovës), Ministria e Infrastrukturës - Drejtoria për rrugë, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari “ – LIMAC, Hekurudhat e Kosovës TRAINKOS Sh. A, RAILTRANS ShPK, ARKEP- Autoriteti rregullativ i komunikimeve elektronike dhe postare , dhe PTK (Posta dhe telekomi i Kosovës).

1.2 Mbulimi

Të dhënat me bazë vjetore që janë shfrytëzuar për publikim janë nga viti 2011 deri në vitin 2020 për mjetet motorike dhe jo motorike, si dhe për rrugët e Kosovës , ndërsa të dhënat me bazë tremujore që janë shfrytëzuar për publikim nga viti 2011 deri në tremujorin e tretë të vitit 2021 janë për transportin ajror, hekurudhor dhe telekomunikimin.

1.3 Përkufizime¹

Rrugë publike - rrugë publike që shërben vetëm për lëvizje të mjeteve motorike, e cila është e shënuar me shenjë të posaçme të trafikut dhe e cila i ka dy shirita rrugorë të ndarë fizikisht për lëvizje nga kahe të kundërta. Shiriti rrugor duhet t'i ketë së paku dy shirita të trafikut me gjerësi së paku 3,5 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit dhe me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e auto udhës, me gjerësi së paku 2,5 metra.

Auto udhë - nënkupton rrugën publike posaçërisht të ndërtuar dhe destinuar vetëm për lëvizjen e mjeteve motorike, e cila është e shënuar me shenjë të posaçme komunikacioni, e cila ka sipërfaqe qarkulluese të ndarë fizikisht për lëvizje nga drejtime të kundërta të shiritave me gjerësi së paku 3,5 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e autostradës, me gjerësi së paku 2,5 metra.

Rrugë nacionale - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë nacionale, e cila lidh dy e më tepër qytete dhe e cilat mund të shërbej si lidhje me rajonet jashtë Kosovës;

Rrugë rajonale - nënkupton rrugën publike e cila lidh qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër regjioneve.

Rrugë lokale - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë lokale, që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune;

¹ Përkufizimet mbi rrugët janë marrë nga Ligji mbi rrugët (“ Ligji nr. 03/L-120”).

Rrugë urbane - nënkuptohet rruga publike që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune.

Rrugë e pa kategorizuar - nënkupton rrugë e cila nuk është caktuar si rrugë publike, por shfrytëzohet për komunikacion si rruga për shfrytëzimin e pyjeve, rruga e liqeve akumulues, rruga për destinim bujqësor e të ngjashme.

Tonë-kilometër (t km) -Njësia e matjes së transportit të mallrave që përfaqëson transportin e një ton të mallrave mbi një distancë prej një kilometri.

Distanca që duhet mbuluar është distanca që aktualisht është udhëtuar në rrjetin e shqyrtuar. Për të shmangur numërimin e dyfishtë, secili vend duhet të llogarisë vetëm t km që kryhet në territorin e saj.

TM - Tremujor

Simbolet

: Mungojnë të dhënat

2. Transporti Hekurudhor

Në territorin e Kosovës kemi gjithsej 333 km binar hekurudhor për transport. Në hekurudhat e Kosovës qarkullojnë gjithsej 11 lokomotiva, prej tyre nënte Disell dhe dy trena motorik. Lokomotivat bartin 10 vagonë për udhëtarë dhe 1420 vagonë për mallra.


Tabela 1 Transporti hekurudhor, TM1 2011 – TM3 2021

Vitet	Numri i pasagjerëve në mijë	Sasia e mallrave të transportuara në mijë ton	Sasia e mallrave të transportuara në milion ton - km.
2011	357,73	1 001,20	40,03
2012	366,55	826,33	48,58
2013	369,27	904,23	43,50
2014	339,58	848,15	39,02
2015	269,15	736,94	23,22
2016	279,21	249,67	7,85
2017	156,62	430,86	14,09
2018	120,13	479,11	15,37
2019	121,06	550,36	23,03
2020	58,82	408,23	16,86
TM 1-2011	83,29	173,11	9,00
TM 2-2011	98,61	247,81	14,00
TM 3-2011	97,44	288,31	17,03
TM 4-2011	78,40	291,97	16,00
TM 1-2012	87,94	173,46	13,09
TM 2-2012	96,00	152,23	6,95
TM 3-2012	94,85	231,18	13,02
TM 4-2012	87,77	269,47	15,51
TM 1-2013	82,35	220,81	8,47
TM 2-2013	95,59	281,59	10,80
TM 3-2013	98,91	171,05	12,20
TM 4-2013	92,41	230,78	12,04
TM 1-2014	91,04	158,26	6,58
TM 2-2014	90,87	227,38	7,75
TM 3-2014	75,42	317,91	15,42
TM 4-2014	82,25	144,61	9,27
TM 1-2015	66,67	200,65	3,49
TM 2-2015	70,63	204,46	6,72
TM 3-2015	65,84	172,79	7,00
TM 4-2015	66,02	159,03	6,00
TM 1-2016	61,43	79,41	1,99
TM 2-2016	82,69	21,54	0,88
TM 3-2016	70,65	14,83	0,48
TM 4-2016	64,43	133,89	4,49
TM 1-2017	51,98	97,91	3,25
TM 2-2017	56,76	132,58	4,39
TM 3-2017	23,05	144,69	4,54
TM 4-2017	24,83	55,68	1,90
TM 1-2018	17,79	76,02	2,33
TM 2-2018	36,94	96,41	2,82
TM 3-2018	32,70	93,22	2,68
TM 4-2018	32,70	213,46	7,55
TM 1-2019	29,45	137,20	4,87
TM 2-2019	29,83	153,01	5,98
TM 3-2019	30,15	121,30	5,65
TM 4-2019	31,63	138,85	6,53
TM 1-2020	21,37	101,23	4,22
TM 2-2020	6,90	144,29	7,04
TM 3-2020	15,38	16,84	0,71
TM 4-2020	15,16	145,87	4,89
TM 1-2021	16,81	187,78	8,05
TM 2-2021	15,46	148,19	6,74
TM 3-2021	11,90	187,30	7,51


Në tremujorin e tretë të vitit 2021, numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi është rreth 12 mijë, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2020, numri i pasagjerëve është zvogëluar për (22.6 %).

Transporti i mallrave me tren në tremujorin e tretë të vitit 2021 është rreth 187 mijë ton.

Graf. 1. Numri i udhëtarëve ne transportin hekurudhor TM1 2011 – TM3 2021



Graf. 2 Sasia e mallrave të bartura përmes transportit hekurudhor TM1 2011 –TM3 2021



3. Transporti Ajror


Numri i fluturimeve në tremujorin e tretë të vitit 2021 është 3,532 në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM3 2020) kemi rritje për 191 %.

Tabela 2 Numri i fluturimeve (arritjet dhe nisjet) TM1 2011 – TM3 2021

Periudha	TM 1	TM 2	TM 3	TM 4	Totali
2011	1 438	1 616	2 103	1 581	6 738
2012	1 424	1 648	2 197	1 678	6 947
2013	1 665	1 809	2 379	1 452	7 305
2014	1 232	1 431	1 941	1 390	5 994
2015	1 269	1 528	2 150	1 387	6 334
2016	1 433	1 676	2 174	1 564	6 847
2017	1 372	1 767	2 384	1 646	7 169
2018	1 560	1 957	2 542	1 862	7 921
2019	1 783	2 173	2 896	1 823	8 675
2020	1 534	94	1 212	1 396	4 236
2021	1 317	1 504	3 532		

Burimi i të dhënave: Aeroporti i Kosovës.

Graf. 3 Numri i fluturimeve sipas tremujorëve TM1 2011 – TM3 2021



Numri i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar aeroplanin si mjet transporti është rreth 524 mijë, në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM3 2020) kemi rritje për 90.58 %.

Tabela 3 Numri i udhëtarëve sipas tremujorëve TM1 2011 – TM3 2021

(në mijë)

Vitet	TM 1	TM 2	TM 3	TM 4	Totali
2011	280	336	482	325	1 422
2012	293	366	530	339	1 527
2013	348	408	560	313	1 629
2014	271	344	472	318	1 405
2015	295	380	541	332	1 549
2016	350	426	573	394	1 744
2017	357	465	645	418	1 885
2018	418	524	721	500	2 162
2019	476	583	783	528	2 370
2020	431	19	275	377	1 102
2021	330	390	524		

Burimi i të dhënave: Aeroporti i Kosovës.

Graf. 4 Numri i udhëtarëve sipas tremujorëve TM1 2011 – TM3 2021




Tabela 4 Numri mesatar i udhëtarëve për një fluturim² TM1 2011 – TM3 2021

Vitet	P e r i u d h a			
	TM1	TM2	TM3	TM4
2011	195	208	228	205
2012	205	222	240	202
2013	209	225	234	215
2014	220	240	242	229
2015	233	249	251	240
2016	245	255	263	252
2017	261	263	269	254
2018	268	268	283	268
2019	267	268	270	290
2020	279	196	229	269
2021	252	255	251	

² Numri mesatar i udhëtarëve është kalkuluar nga numri i udhëtarëve për tre-mujorë në raport me numrin e fluturimeve për tre-mujorë.

4. Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara


Në vitin 2020 në Kosovë janë të regjistruara 356,962 mjete motorike dhe jo motorike, në raport me vitin 2019 kemi rritje për 0.31 %.

Tabela 5 Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara 2011-2020

Vitet	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Vetura	170,321	176,398	222,537	236,145	281,847	260,291	273,862	280,422	291,295	292,902
Automjet trans,3.5 dhe mbi 3.5t	10,877	11,547	15,352	15,769	18,330	17,963	18,559	33,889	35,153	19,060
Automjet trans,nën 3.5t	17,901	18,225	24,659	26,949	30,846	31,285	32,299	19,371	19,379	35,705
Kombibuset	2,698	2,520	3,225	3,161	3,212	2,841	2,535	2,917	2,977	1,768
Autobuset	1,117	1,298	1,570	1,697	2,124	1,916	1,949	2,326	2,135	1,794
Motoçikleta	546	809	1,488	1,540	1,849	1,790	1,690	2,038	2,087	1,694
Traktorë	39	137	776	1,036	941	613	523	1,791	1,851	641
Rimorkio nën 3.5t	101	117	217	250	286	288	288	572	681	297
Rimorkio 3.5 dhe mbi 3.5t	1,766	1,800	2,283	2,281	2,707	2,628	2,735	305	271	3,101
Gjithsej	205,366	212,851	272,107	288,828	342,142	319,615	334,440	343,631	355,829	356,962

Burimi i të dhënave: Ministria e Punëve të Brendshme

Graf. 5 Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara 2011 – 2020



5. Rrugët e Kosovës

Që nga pas lufta e gjerë në vitin 2020 janë bërë investime kapitale në ndërtimin e rrugëve në Kosovë. Pasi që investimet janë në vijim, ende nuk është bërë ri klasifikimi i rrugëve. Klasifikimi i rrugëve, sipas standardeve të ndërtimit bëhet nga bordi i drejtorive përkatëse.

ASK-ja (Agjencia e Statistikave të Kosovës) nga Ministria e Infrastrukturës për vitet 2009 dhe 2010 ka marrë vetëm ndryshimet në gjatësinë e rrugëve Nacionale dhe Regjionale kurse duke filluar nga viti 2011 e këndej kemi filluar të pranojmë edhe të dhënat për kategorinë - Auto udhë. Kështu gjatë vitit 2011 kemi pasur gjithsej 38 km Auto udhë të reja, në vitin 2012 kësaj i janë shtuar edhe 22.4 km gjatë vitit 2013 po ashtu janë shtuar edhe 17.6 km, në vitin 2016 janë shtuar 20 km , ne vitin 2017 janë shtuar 10 km , në vitin 2018 janë shtuar 11 km, kurse ne vitin 2019 janë shtuar 18.1 km dhe tani gjatësia e Auto udhës³ gjithsej është 137.2 km. Në vitin 2018 janë shtuar 11.3 km rrugë Nacionale, ne vitin 2019 janë shtuar 23.4 km, ne vitin 2020 janë shtuar 90.00 km dhe tani gjatësia e rrugëve Nacionale është 755.2 km. Në vitin 2015 janë shtuar 10.3 km rrugë Regjionale ,në vitin 2018 janë shtuar 8.9 km, kurse ne vitin 2019 janë shtuar 195.5 km. Gjate vitit 2019 dhe 2020 kanë ndodh disa kategorizime dhe ri-kategorizime te rrugëve. Disa rruge lokale janë kategorizuar ne rruge regjionale por dhe nga rruga regjionale janë ri-kategorizuar ne rruge nacionale, dhe tani gjatësia e rrugës Regjionale është 1,486.3 km.

Tabela 6 Gjatësia e rrugëve të Kosovës sipas kategorive në km 2011-2020

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Autoudhë	38.0	60.4	78.0	78.0	78.0	98.0	108.0	119.1	137.2	137.2
Nacionale	630.4	630.4	630.4	630.4	630.4	630.4	630.4	641.7	665.2	755.2
Regjionale	1,294.7	1,294.7	1,294.7	1,294.7	1,305.0	1,305.0	1,305.0	1,313.9	1,509.4	1,486.3
Totali	1,963.1	1,985.5	2,003.1	2,003.1	2,013.4	2,033.4	2,043.4	2,074.7	2,311.7	2,378.7

Burimi i të dhënave: Ministria e Infrastrukturës

Sipas të dhënave të prezantuara vërehet se në vitin 2020 në territorin e Kosovës kemi 2,378.7 km, ku në kategorinë e rrugëve Auto udhë janë 5.8%, Nacionale 31.7% ndërsa 62.5% janë rrugë Regjionale.

³ Të dhënat për gjatësinë e Auto udhës janë marrë nga Ministria e Infrastrukturës

Graf. 6 Struktura e rrugëve të Kosovës sipas kategorive në %





Tabela 7: Rrugët e Kosovës të asfaltuara dhe të pa asfaltuara në kilometra (km) 2011 -2020

Përshkrimi/ vitet	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Rrugë të Asfaltuara	1,843.0	1,865.4	1,883.0	1,883.0	1,923.4	1,943.4	1,953.4	1,979.3	2,210.7	2,297.7
Rrugë të pa asfaltuara	120.1	120.1	120.1	120.1	90.0	90.0	90.0	95.4	101.0	81.0
Totali	1,963.1	1,985.5	2,003.1	2,003.1	2,013.4	2,033.4	2043.4	2074.7	2311.7	2378.7

Burimi i të dhënave: Ministria e Infrastrukturës

Nga tabela e mësipërme vërehet se në vitin 2020 nga gjithsejtë 2,378.7 km rrugë, 2,210.7 km apo shprehur në përqindje 96.6% janë rrugë të asfaltuara, ndërsa 81 km apo 3.4 % e rrugëve janë të pa asfaltuara.

Graf. 7 Struktura e rrugëve të Kosovës sipas kategorive



6.Telekomunikimi

6.1. Përdoruesit dhe Impulset e telefonisë fikse

Tabela 8 Përdoruesit dhe Impulset TM1 2011 – TM3 2021⁴

Përiudha		Mesatarja e parapagusve në mijë	Numri i impulsave në milion
2011	TM 1 - 2011	78,4	65,3
	TM 2 - 2011	78,9	63,6
	TM 3 - 2011	82,4	59,7
	TM 4 - 2011	83,9	65,3
2012	TM 1 - 2012	86,2	35,4
	TM 2 - 2012	85,4	34,2
	TM 3 - 2012	84,5	34,2
	TM 4 - 2012	85,4	34,6
2013	TM 1 - 2013	81,3	32,1
	TM 2 - 2013	82,4	32,3
	TM 3 - 2013	83,5	33,2
	TM 4 - 2013	79,4	27,4
2014	TM 1 - 2014	77,7	24,5
	TM 2 - 2014	76,4	24,0
	TM 3 - 2014	74,7	22,6
	TM 4 - 2014	72,8	21,0
2015	TM 1 - 2015	71,4	18,3
	TM 2 - 2015	70,1	19,1
	TM 3 - 2015	70,6	18,4
	TM 4 - 2015	70,7	18,6
2016	TM 1 - 2016	71,4	18,3
	TM 2 - 2016	48,6	12,8
	TM 3 - 2016	47,6	13,6
	TM 4 - 2016	48,1	13,4
2017	TM 1 - 2017	45,1	11,4
	TM 2 - 2017	43,9	7,8
	TM 3 - 2017	42,9	10,4
	TM 4 - 2017	41,9	9,8
2018	TM 1 - 2018	35,3	10,1
	TM 2 - 2018*	61,4	23,3
	TM 3 - 2018	60,0	11,5
	TM 4 - 2018	58,5	15,6
2019	TM 1 - 2019	56,6	10,6
	TM 2 - 2019	56,1	13,2
	TM 3 - 2019	57,5	14,3
	TM 4 - 2019	56,1	15,0
2020	TM 1 - 2020	54,4	13,5
	TM 2 - 2020	77,3	13,2
	TM 3 - 2020	76,8	12,0
	TM 4 - 2020	76,9	12,1
2021	TM 1 - 2021	75,2	11,6
	TM 2 - 2021	74,4	12,8
	TM 3 - 2021	;	;

Burim i të dhënave ARKEP (Autoriteti rregullativ i komunikimeve elektronike dhe postare).

⁴ 5 Bazuar në kërkesën e Eurostat-it duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2018 (TM 2 2018), janë të përfshira të dhëna edhe nga operatore të tjerë, në mënyrë që të mbulohej të gjitha shërbimet e telekomunikimit të ofruara në vendin tonë.

6.2. Përdoruesit e telefonisë mobile


 Tabela 9 Përdoruesit e telefonisë mobile TM1 2011 – TM3 2021⁵

Përiudha		Pri-Paid në mijë	Post-Paid në mijë	Totali i shfrytëzuar i telefonisë mobile në mijë
2011	TM 1 - 2011	900,66	49,92	950,58
	TM 2 - 2011	904,70	49,67	954,36
	TM 3 - 2011	958,88	45,77	1 004,64
	TM 4 - 2011	956,69	45,23	1 001,92
2012	TM 1 - 2012	908,04	45,67	953,71
	TM 2 - 2012	904,69	36,05	940,74
	TM 3 - 2012	970,01	36,24	1 006,25
	TM 4 - 2012	927,58	39,32	966,90
2013	TM 1 - 2013	927,58	39,32	966,90
	TM 2 - 2013	929,52	34,84	964,35
	TM 3 - 2013	917,07	34,85	951,92
	TM 4 - 2013	914,62	36,33	950,95
2014	TM 1 -2014	867,36	30,79	898,15
	TM 2 - 2014	840,04	29,73	869,76
	TM 3 - 2014	863,62	28,10	891,72
	TM 4 - 2014	854,73	28,56	883,29
2015	TM 1 - 2015	820,31	29,13	849,44
	TM 2 - 2015	797,89	29,62	827,51
	TM 3 - 2015	867,88	24,67	892,55
	TM 4 - 2015	828,70	27,92	856,61
2016	TM 1 - 2016	935,91	39,45	975,36
	TM 2 - 2016	943,08	39,62	982,70
	TM 3 - 2016	963,16	40,02	1 003,18
	TM 4 - 2016	904,61	44,91	947,33
2017	TM 1 - 2017	1 190,72	50,85	1 241,57
	TM 2 - 2017	904,72	44,91	949,65
	TM 3 - 2017	770,09	44,28	949,65
	TM 4 - 2017	1107,34	44,43	1 151,77
2018	TM 1 - 2018	743,87	41,92	785,79
	TM 2 - 2018*	1708,13	163,89	1 872,01
	TM 3 - 2018	1871,65	178,12	2 049,77
	TM 4 - 2018	1779,98	186,10	1 966,08
2019	TM 1 - 2019	1740,40	195,67	1 936,07
	TM 2 - 2019	1674,27	201,57	1 875,83
	TM 3 - 2019	1563,72	111,17	1 674,89
	TM 4 - 2019	1861,55	211,73	2 073,28
2020	TM 1 - 2020	1787,42	221,93	2 009,35
	TM 2 - 2020	1622,61	221,19	1 843,80
	TM 3 - 2020	1720,32	222,66	1 942,97
	TM 4 - 2020	1755,61	228,31	1 983,92
2021	TM 1 - 2021	1739,29	235,89	1 975,18
	TM 2 - 2021	1698,57	242,91	1 941,48
	TM 3- 2021	;	;	;


Burim i të dhënave ARKEP (Autoriteti rregullativ i komunikimeve elektronike dhe postare).

⁵ Bazuar në kërkesën e Eurostat-it duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2018 (TM 2 2018), janë të përfshira të dhëna edhe nga operatore të tjerë, në mënyrë që të mbulohen të gjitha shërbimet e telekomunikimit të ofruara ne vendin tonë.

Graf. 8 Shfrytëzuesit Post-Paid



Graf. 9 Shfrytëzuesit Pri-Paid




6.3. Kapaciteti i zyrave Postare

Tabela 10 Numri i zyrave postare të shfrytëzuara dhe të pashfrytëzuara

Posta	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Zyrat Postare	177	177	177	177	177	177	177	174	174	169
Zyrat postare të shfrytëzuara	166	166	166	166	166	166	166	133	133	129
Zyrat postare të pa shfrytëzuara	11	11	11	11	11	11	11	41	41	40

Burim i të dhënave Posta dhe Telekomit i Kosovës

Graf. 10 Numri i zyrave postare të shfrytëzuara dhe të pa shfrytëzuara ne vitin 2020



Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka ketë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** + 383 (0) 38 200 31 129
- **Kryeshefi Ekzekutiv:** + 381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** + 383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>